Kronikë

Kërcënimi me armë ndaj gazetarëve në Krujë, shpallen në kërkim 3 persona! Nis hetimi ndaj 2 shoferëve të kamionëve dhe 2 punonjësve të IKMT

Tre persona janë shpallur në kërkim nga policia e Durrësit pasi kërcënuan me armë gazetarët e emisionit investigativ 'Fiks Fare'. Po ashtu ka nisur hetimi ndaj 2 shoferëve të kamionëve dhe 2 punonjësve të IKMT.

Një nga personat e armatosur që kërcënoi gazetarët

Redaksia
9 Shkurt, 20:15 | **Përditësimi: 9 Shkurt, 21:26**

Tre persona janë shpallur në kërkim nga policia e Durrësit pasi kërcënuan me armë gjahu gazetarët e emisionit investigativ 'Fiks Fare'. Ata kanë identifikuar si: E. K. (drejtuesi i ekskavatorit), G. K., 30 vjeç dhe H. V., 30 vjeç, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë kërcënuar grupin e xhirimit, duke qëlluar me armë gjahu, në basenin e lumit Zezë.

Po në kuadër të veprimeve të para hetimore të kryera për këtë rast, nisën hetimet ndaj: A. L. (drejtuesi i kamionit) dhe E. Gj. (drejtuesi i kamionit), për veprat penale "Shpërdorimi i tokës" dhe "Kanosja për shkak të detyrës". Gjithashtu, këtyre shtetasve iu sekuestruan mjetet e tonazhit të rëndë që përdornin në basen.

LEXO EDHE:
Krujë, 46-vjeçari godet me kosore një person, arrestohet nga policia

Gjithashtu, në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u referuan materialet në Prokurori dhe nisën hetimet për dy punonjës të IKMT, Drejtoria Rajonalde Durrës të identifikuar si E. B. dhe F. Sh., pasi duke qenë përgjegjës për monitorimin e kësaj zone, dyshohet se kanë konsumuar elemente të veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Materialet për këtë rast i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Një ditë më parë, grupi i xhirimit të emisitonit 'Fiks Fare' gjatë filmimeve për gërryerjet e paligjshme në lumin Zezë në Nikël të Krujësjanë përballur me ***persona me armë*** të cilët qëllonin drejt dronit. Ata shfaqeshin duke drejtuar armët ndërsa qëndronin vetëm pak metra larg grupit të xhirimit,të pozicionuar në një vend që mezi dalloheshin.

Ndërsa gazetarët xhironin kamionët me inerte që dilnin nga lumi dhe prisnin ardhjen e policisë pas telefonatës që kishin bërë me Shefin e Komisariatit të Policisë Krujë, drejt gazetarëve shkuan dy personat e parë të cilët urdhëruan gazetarët të ikin nga aty, me pretendimin se lumi është i tyre.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: fiks fare | kercenim me armë | gazetare | Durres

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni pjesëmarrjen në protestën e opozitës?

Të lartë | Të ulët | Nuk e di

Lajme të tjera

3 vite pas tërmetit të 26 nëntorit, banorët kërkojnë rikonstruksionin e pallatit 12-katësh: Të nisë sa më shpejt puna! Po qëndrojmë jashtë

Aldo Mustafa

10 Shkurt, 13:32

Lihet në burg babai që do të shiste për 5 mijë euro fëmijën! Dëshmia në gjykatën e Durrësit: Isha i dehur! Më lini të lirë, jam i vetmi që mbaj familjen

10 Shkurt, 11:34

VIDEO/ Merr flakë ngrohësja e korrentit me të cilën po ngrohej, digjet banesa në Fushë Krujë, ndërron jetë 92-vjeçari

9 Shkurt, 14:37

U kap me 5 kg heroinë në Itali, kuzhinieri i tragetit të Linjës Durrës-Ankona: Gabova! Do e dorëzoja jashtë portit dhe dikush do të më paguante

9 Shkurt, 13:44

Kultivimi i 20 mijë rrënjëve kanabis në maj të vitit 2021 në fshatrat e Krujës, vihet në pranga 51 vjeçari, shkon në 21 numri i të arrestuarve

9 Shkurt, 11:55

Rama: Çelen tre konkurse ndërkombëtare për stadiumet e Vlorës, Durrësit dhe Korçës

8 Shkurt, 20:16

Mashtroi për shitjen e një dyqani në Durrës me vlerë 72 mijë euro, kapet në Greqi 63-vjeçari! I dënuar me 15 vite burg, pritet ekstradimi i tij

8 Shkurt, 10:54

Pajisi me pasaporta bullgare false 5 turq, arrestohet në Portin e Durrësit 41-vjeçari me origjinë nga Anglia

8 Shkurt, 09:07

Rama publikon pamjet: Vijojnë punimet për Lungomaren e Durrësit

8 Shkurt, 08:14

Rindërtimi/ Rama ndan fotot: Puna për shndërrimin e lagjes së prekur nga tërmeti në Durrës vijon! Do strehohen 996 familje

7 Shkurt, 16:56

Skandal/ Prindërit në Durrës shesin 5000 euro fëmijën në barkun e nënës! Babai bën pazaret: Bëj ç'të duash me beben, s'më intereson!

6 Shkurt, 22:24

Aksi Durrës-Elbasan do ketë pengesa në qarkullim, Report Tv siguron pamje të mjetit që do lëvizë në rrugë nga ora 22:00 (VIDEO)

5 Shkurt, 18:30

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje